



## URDHËR

Nr. 17160, datë 10-052017

### THIRRJEN PËR APLIKIM “PËR PROGRAMIN SOCIAL TË STREHIMIT “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”

Në mbështetje të nenit 3, nenit 8, nenit 9, pika 1/1/1, shkronjat (a) dhe (b), nenit 24, nenit 64, shkronjat (a) dhe (b) të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit”(i ndryshuar); vendimit nr. 20, datë 20.02.2017 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin dhe zbatimin e programit social te strehimit “subvencionimi i interesave të kredisë, hartuar sipas udhëzuesit operacional”,

### URDHËROJ:

1. Njoftim për thirrjen e aplikimit sipas “Programit Social të Strehimit Subvencionimi i Interesave të Kredisë” dhe zbatimin e tij sipas udhëzuesit operacional, bashkëlidhur vendimit nr. 20, datë 20.02.2017 të Këshillit Bashkiak.
2. Çdo aplikues, i cili nga data 07.03.2017 dhe deri në daljen e këtij urdhri, ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë Drejtorisë së Strehimit Social në kuadër të Programit të Kredisë e Lehtësuar nga Shteti, konsiderohet aplikim i vlefshëm, në rast se i interesuari paraqitet dhe plotëson formularin e aplikimit sipas programit social të strehimit të parashikuar në pikën 1 të këtij urdhri.
3. Për efekt të këtij urdhri, konsiderohet dokumentacion i vlefshëm ai i lëshuar nga organet përkatëse gjatë 3 muajve të fundit.
4. Aplikimi për të dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj thirrjeje është i hapur deri më datë 8 Qershor 2017.
5. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse e Bashkisë Tiranë për zbatimin dhe ndjekjen e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe njoftohet pranë çdo Njësie Administrative të Bashkisë Tiranë.

KRYETAR

ERION VELIAJ

